VENDIM
Nr. 704, datë 30.10.2019

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2019, MIRATUAR PËR MINISTRINË E MBROJTJES DHE MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT PËR RIKONSTRUKSIONIN DHE RINDËRTIMIN E BANESAVE TË PREKURA NGA TËRMETI NË DATAT 21.9.2019 DHE 26.11.2019, NË QARQET TIRANË, DURRËS DHE LEZHË, SI EDHE PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË AKOMODIMIT TË PËRKOHSHËM TË TË DËMTUARVE

(ndryshuar me VKM nr. 811, datë 13.12.2019)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2019, akordohen fondet si më poshtë:

a) Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2019, në programin buxhetor "Emergjencat civile" 10910, i shtohet fondi prej 200 000 000 (dyqind milionë) lekësh, për rikonstruksionin dhe rindërtimin e shtëpive të dëmtuara në qarqet Tiranë, Durrës dhe Lezhë.

b) Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në buxhetin e miratuar për vitin 2019, në programin buxhetor "Zhvillimi i turizmit" 04760, për institucionin Agjencia Kombëtare e Bregdetit, i shtohet fondi prej 270 000 000 (dyqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh, për akomodimin e përkohshëm të të dëmtuarve në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë.

2. Ministria e Mbrojtjes caktohet organi përgjegjës për përdorimin e fondeve për rikonstruksionin dhe rindërtimin e shtëpive të dëmtuara nga tërmeti, *në qarqet Tiranë, Durrës dhe Lezhë*, sipas procedurave të prokurimit publik.

3. Të gjitha fondet në programin buxhetor "Emergjencat Civile" 10910, për vitin 2019, do të përdoren *për qëllimin e parashikuar në shkronjën "a", të pikës 1*, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama